



DEPUTETËT NUK E KONSTITUOJNË KUVENDIN AS NË PËRPPJEKJEN E 34-TË

VETËVENDOSJA PRET KUSHTETUESËN, PARTITË E TJERA KËRKOJNË MARRËVESHJE POLITIKE

FAÇE 4-5



Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur të konstituohet as në përpjekjen e 34-të, duke thelluar edhe më shumë krizën institucionale që e ka mbërthyer vendin që nga

zgjedhjet e 9 shkurtit. Edhe të enjten, sikurse në tentimet e mëparshme, nuk pati konsensus ndërmjet partive politike për ta zgjedhur kryetarin e

Kuvendit dhe për ta vazhduar formimin e institucioneve të reja. Ata do të mbledhen sërish pas 48 orësh, përkatësisht të shtunën, më 21 qershor

**UDHËHEQJA E OVLUCK-së
TAKOHET ME DEPUTETË
ZVICERANË: GJYKATA
SPECIALE PO
VEPRON NË MËNYRË
TË PADREJTË** F. 7



**PËR HERË TË
PARË MBAHET
SEANCË
GJYQËSORE
PËRMES
VIDEOLIDHJES** F. 6



**ADMINISTRIMI I TOKËS,
GARANTUES I SIGURISË
LIGJORE PËR PRONËN** F. 8

**PAS 1 KORRIKUT NJË
KAFFE MUND TË KUSHTOJË
DERI NË TRI EURO** F. 8

SPORT



**VENDOSËT GURTHEMELI I PISHINËS
GJYSMË-OLIMPIKE NË PODUJEVË**

F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030-500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Hegseth: Ushtria amerikane është e gatshme ta zbatojë çdo vendim të Trumpit për Iranin

UASHINGTON, 19 QERSHOR - Ushtria amerikane është e gatshme të zbatojë çdo vendim që presidenti Donald Trump mund ta marrë në lidhje me Iranin, deklaroi të mërkurën sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth, duke lënë të kuptohet se qëllimi i ShBA-së mund të bëhet më i qartë në ditët në vijim.

Duke dëshmuar para një komiteti të Senatit, Hegseth ishte shumë i kujdesshëm në deklaratat e tij publike, duke mos pranuar të thotë nëse Pentagoni ka përgatitur opsione për sulme ndaj Iranit. Megjithatë, kur u pyet me këmbëngulësi nga ligjvënësit, ai pranoi se është i gatshëm ta zbatojë çdo urdhër në lidhje me Iranin dhe paralajmëroi se

Teherani duhet ta kishte dëgjuar thirrjen e Trumpit për të bërë marrëveshje mbi programin bërthamor para se Izraeli t'i fillonte sulmet ajrore të premten.

"Ata duhet të kishin bërë marrëveshje. Fjala e presidentit Trump ka peshë. Bota e kupton këtë. Dhe, në Departamentin e Mbrojtjes, puna jonë është të jemi gati dhe të përgatitur me opsione - dhe pikërisht këtë po bëjmë", tha Hegseth para Komitetit të Forcave të Armatosura të Senatit.

Më herët të mërkurën, Trumpi nuk iu përgjigj pyetjeve të gazetarëve nëse Shtetet e Bashkuara do ta sulmojnë Iranin apo objektet e tij bërthamore, por tha se durimi i



tij është sosur.

Duke folur pranë Shtëpisë së Bardhë, Trumpi e përsëriti thirrjen e tij për "dorëzimin e pakushtëzuar" të Iranit. "Mund ta bëj, mund të mos e bëj. Dua

të them, askush nuk e di çfarë do të bëj", u tha Trump gazetarëve kur u pyet nëse ka vendosur t'i fillojë bombardimet kundër Iranit. Trumpi tha se Irani kishte lënë

të kuptohet se dëshiron të dërgojë zyrtarë të vet në Shtëpinë e Bardhë për të biseduar mbi programin bërthamor të Teheranit dhe për t'i ndalur sulmet ajrore të Izraelit, por shtoi se "është shumë vonë".

Izraeli i nisi bombardimet ndaj Iranit të premten e kaluar dhe të mërkurën ushtria izraelite tha se ka kryer sulme në Iranin perëndimor, duke goditur depo raketore dhe një raketahedhës të mbushur. Izraeli i ka goditur disa objekte bërthamore dhe ushtarake, duke vrarë gjeneralë të lartë dhe shkencëtarë bërthamorë. Irani i ka lëshuar rreth 400 raketa dhe qindra dronë në sulme hakmarrëse ndaj Izraelit që nga ajo ditë.

Zelensky bën thirrje për rritjen e presionit ndaj Rusisë

KIEV, 19 QERSHOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky tha se sulmet raketore ruse ndaj një ndërtese banimi në Kiev të martën ishin shenjë se duhet të ushtrohet më shumë presion ndaj Moskës në mënyrë që ajo të pajtohet për një armëpushim.

Rusia së fundmi ka shtuar sulmet në luftën kundër Ukrainës, që ka nisur tre vjet më parë. Sulmet me dronë dhe raketa në Kiev të martën - më vdekjeprurëse ndaj kryeqytetit ukrainas gjatë këtij viti - lanë të vrarë 28 persona dhe plagosën 142 të tjerë.

Zelensky, së bashku me



ministrin e tij të Brendshëm, Ihor Klymenko, vizituan vendin

ku gjendet ndërtesa e banimit e sulmuar. Ata vendosën kurora

me lule dhe nderuan kujtimin e 23 personave që humbën jetën nga sulmi.

"Ky sulm është përkujtues për botën se Rusia refuzon armëpushimin dhe zgjedh vrasjet", shkroi Zelensky në "Telegram".

Ai falënderoi partnerët e Ukrainës, të cilët, sipas Zelenskyt, janë të gatshëm ta rrisin presionin ndaj Rusisë në mënyrë që Moska "ta ndiejë koston e vërtetë të luftës".

Gjatë sulmeve të së martës në Kiev dhe në pjesë të tjera të Ukrainës, sipas zyrtarëve në Kiev, Rusia përdori mbi 440 dronë dhe 32 raketa.

Javët e fundit Rusia ka shtuar sulmet me armë me reze të gjatë veprimi, duke goditur zona të banuara. Megjithatë, një ditë më parë, presidenti rus, Vladimir Putin, mohoi se shteti i tij sulmon civilët, duke thënë se sulmet "janë kundër industrisë ushtarake, e jo ndaj ndërtesave të banimit". Ai tha se është i hapur për të negociuar me Zelenskyn, por përsëriti qëndrimin e tij se udhëheqësi ukrainas nuk ka legjitimitet, pasi i ka përfunduar mandati pesëvjeçar si president - pretendim që vazhdimisht është hedhur poshtë nga Kiev.

Të paktën 25 të vrarë nga sulmet izraelite në Gazë

GAZË, 19 QERSHOR - Agjencia për Mbrojtje Civile në Gazë tha se si pasojë e sulmeve izraelite janë vrarë të paktën 25 persona, përfshirë 15 që ishin mbledhur pranë një qendre për shpërndarjen e ndihmës.

Zyrtari i kësaj agjencie, Mohammad al-Mughayyir, tha për AFP-në se 15 persona u vranë dhe 60 të tjerë u plagosën teksa po prisnin për ndihma në korridorin Netzarim, në pjesën qendrore të Gazës, ku mijëra persona mbledhen përditë me shpresën se do të marrin ushqime.

Ushtria izraelite tha se po heton raportimet për sulme vdekjeprurëse pranë qendrave të ndihmës.

Bassam Abu Shaar, dëshmitar okular, tha se mijëra persona ishin mbledhur gjatë natës me shpresën se do të merrnin

ndihma nga qendra - që operohet nga një fondacion i mbështetur nga Izraeli dhe Shtetet e Bashkuara - kur ajo të hapej në mëngjes. "Rreth orës 01:00 [sipas kohës lokale], ata nisën të shtinin drejt nesh. Më pas, zjarri u shtuar nga tanket dhe avionët", tha ai për AFP-në. Në javët e fundit dhjetëra palestinezë janë vrarë teksa tentonin të arrinin në qendrat për ndihma në Gazë.

Në mars, Izraeli vendosi një bllokadë të përgjithshme për hyrjen e ndihmave në territorin palestinez dhe e hoqi pjesërisht atë në fund të majit. Që atëherë, Fondacioni Humanitar për Gazën, i mbështetur nga Izraeli dhe ShBA-ja, ka nisur shpërndarjen e ndihmave dhe para qendrave të tij janë parë skena kaotike.

Agjencia e Kombeve të

Bashkuara dhe organizata të tjera të mëdha të ndihmës kanë refuzuar të bashkëpunojnë me këtë fondacion, duke shprehur shqetësime se ai është krijuar për ta ndihmuar Izraelin t'i arrijë qëllimet ushtarake.

Gjetkë në Gazë, edhe dhjetë persona të tjerë u vranë nga sulmet izraelite më 19 qershor, tha Agjencia për Mbrojtje Civile në Rripin e Gazës. Sipas kësaj agjencie, tre u vranë kur u bombardua një ndërtesë banimi në Qytetin e Gazës dhe shtatë të tjerë pas një sulmi ajror në kampin e refugjatëve Al-Shati.

Lufta në Gazë filloi kur militantë të udhëhequr nga Hamasi - grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian - sulmuan jugun e Izraelit, duke vrarë afër 1 200



njerëz dhe duke marrë rreth 250 pengje. Izraeli thotë se 58 pengje mbeten ende në Gazë, megjithëse besohet se rreth 35 prej tyre janë të vdekur. Që

atëherë Izraeli ka vrarë më shumë se 55 000 njerëz në Gazë, shumë prej tyre gra dhe fëmijë, sipas zyrtarëve shëndetësorë palestinezë.

Kurti bën homazhe te Kompleksi Memorial “Heroinat”

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, së bashku me anëtarë të kabinetit qeveritar dhe zyrtarë nga Zyra e Kryeministrit, bëri homazhe dhe vendosi lule të freskëta pranë Kompleksit Memorial “Heroinat” në Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Seksuale në Konflikt.

Në këtë ditë të shënuar ndërkombëtare, Agjencia për Barazi Gjinore shënoi 20-vjetorin e themelimit të saj dhe, me këtë rast, në ambientet e parkut “Heroinat”, organizoi një aktivitet simbolik sensibilizues, “Gjelbërimi i ambientit” me bimë dekoruese. “Me mbjelljen e bimëve nderojmë dhembjen, sakrificën dhe guximin që nuk

do të harrohet kurrë!”, thuhet në mbishkrimin e pllakës së vendosur aty në kujtim të grave viktime të dhunës seksuale gjatë luftës.

Në këto homazhe përkujtimore dhe ndërgjegjësuere, të organizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, të pranishëm, krahas

kryeministrit Kurti, ishin edhe zëvendëskryeministri i parë në detyrë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi, ministria në detyrë e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ministria në detyrë e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, drejtoresha ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore, Edi Gusia, si dhe deputetë të



Kuvendit e kolegë nga kabinetit qeveritar.

KOSOVA, VENDI MË I CENUESHËM NGA LUFTA HIBRIDE

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Instituti për Hulumtime dhe Zhvillim në Prishtinë (PIRDEV) ka mbajtur të enjten konferencë lidhur me bashkëpunimin ndërkufitar, me temën “Modeli i ri i integritetit për Ballkanin Perëndimor”. Në panelin e parë u diskutua për demokracinë në epokën hibride, kërcënimet hibride, integritetin e zgjedhjeve dhe ndikimet nga jashtë. Në këtë diskutim, ndër të tjera, u tha se Kosova është vendi më i cenueshëm nga lufta hibride.

Pjesë e kësaj konference ishte edhe zëvendëskryeministri i Maqedonisë së Veriut, Izet Mexhiti, i cili tha se ky vend ballafaqohet me luftë hibride dhe lajme të rreme, mirëpo në vazhdimësi po punohet për të ndërtuar mbrojtje nga kjo luftë. Duke folur për integritetin e zgjedhjeve, ai tha se sistemi më i drejtë zgjedhor është kur mandati merret drejtpërdrejt nga qytetari dhe jo kur delegohet. Madje Mexhiti e lavdëroi

Kosovën, siç tha, për sistemin zgjedhor dhe listat e hapura pasi, sipas tij, në Maqedoninë e Veriut është sistemi proporcional, përmes të cilit deputetë zgjidhen më shumë ata që janë lojalë ndaj liderit politik. “Maqedonia e Veriut ballafaqohet me lajme të rreme dhe luftë hibride, ku mundohemi ta kapim hapin edhe pse jemi të kufizuar me buxhet. Mirëpo po punohet në këtë drejtim për të ndërtuar mbrojtje nga kjo luftë, e cila është aktuale dhe problem për cilëndo qeveri, e sidomos të rajonit. Në parim, mendoj se më i drejtë është kur mandati merret drejtpërdrejt nga qytetari sesa kur delegohet, por edhe ato kanë nuancat dhe modelet e veta. Unë mendoj se modeli më i mirë janë listat e hapura në Kosovë, të cilat mundësojnë që deputetë të bëhen ata që janë më të votuar dhe kanë përkrahje, ndërsa në Maqedoninë e Veriut është sistemi proporcional, ku kryesisht respektohet kriteri i



lojalitetit ndaj liderit”, tha ai. Kosova, sipas kryetarit të komunës së Gjakovës, njëherësh nënkryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjini, është më e cenueshmja nga lufta hibride

në rajon. Ai gjatë diskutimit tha se lufta hibride në mënyrën më të sofistikuar është përdorur që një kohë të gjatë në Kosovë. Sipas tij, qëllimi kryesor është të krijohet hamendje te qytetarët. Sa i përket demokracisë dhe

integritetit zgjedhor, Gjini nënvizoi nevojën që në Kosovë të largohet votimi preferencial pasi, sipas tij, përfaqësimi në Kuvend nuk është kualitativ. Ndërsa drejtori i Plug and Play Tech Center për Ballkanin Perëndimor, Uranik Begu, ngriti shqetësimin se zhvillimi i teknologjisë do të bëhet më i sofistikuar dhe do t’u japë mundësi më shumë atyre që kanë synim destabilizimin dhe ndërhyrjen në vende të ndryshme, kryesisht përmes lajmeve të rreme. “Ky është një fenomen dhe proces që ka për të ardhur duke u përshkallëzuar edhe më keq. Mundësia dhe zhvillimi i teknologjisë ka për të mundësuar që ata që kanë synim për destabilizim apo për të krijuar atë që quhet ‘fake news’ apo lajme të rreme, do të kenë teknologji të sofistikuar”, shtoi ai.

Në këtë konferencë u diskutua edhe për bashkëpunimin ndërkufitar dhe mikro-rajonet. (kp)

GËRVALLA: E ARDHMJA JONË ËSHTË NË BE



PRISHTINË, 19 QERSHOR - Zëvendëskryeministria dhe ministria në detyrë e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, në kuadër të Takimit Ministror të mbajtur në Taormina, përmendi shënimin e Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Seksuale në konflikt, ku theksoi rëndësinë e drejtësisë dhe të kujtesës në ndërtimin e së ardhmes evropiane. Në fjalën e saj para homologëve

evropianë, ministria Gërvalla rikujtoi se dhuna seksuale është përdorur si armë lufte nga regjimi serb ndaj grave, burrave dhe fëmijëve në Kosovë, Kroaci dhe Bosnjë. Ajo theksoi se, përkundër vuajtjeve të viktimave, autorët e këtyre krimeve vazhdojnë të jetojnë të lirë në Serbi, shpeshherë të shpërblyer me poste dhe privilegje. “Heshtja e vazhdueshme e institucioneve ndërkombëtare të drejtësisë

përbën rrezik për përsëritjen e historisë. E ardhmja jonë është në Bashkimin Evropian, por si pjesë e një Evrope që mbron të vërtetën, njeh të kaluarën dhe ndërton paqe përmes drejtësisë”, ka thënë ministria Gërvalla.

Ajo ka theksuar se Evropa, vetëm duke u qëndruar besnike vlerave të saj, mund ta ruajë koherencën, besimin dhe rolin e saj si faktor qendror i drejtësisë dhe paqes në rajon dhe në botë.

Haradinaj pret në takim udhëheqësin e ri të misionit të OSBE-së në Kosovë

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka prituri në takim Gerard McGurk, udhëheqësin e ri të Misionit të OSBE-së në Kosovë. Gjatë takimit Haradinaj i uroi

mirëseardhje ambasadorit McGurk dhe i dëshiroi suksese në detyrën e re. Në fokus të bisedës ishte vazhdimi i bashkëpunimit me OSBE-në në funksion të forcimit të demokracisë, të drejtave të njeriut dhe

sundimit të ligjit në Kosovë. Haradinaj kërkoi mbështetjen e mëtejshme të misionit, duke shprehur gatishmërinë e tij dhe të Aleancës për të bashkëpunuar ngushtë me OSBE-në.





DEPUTETËT NUK E KONSTITUOJNË KUVENDIN AS NË PËRPPJEKJEN E 34-TË

VETËVENDOSJA PRET KUSHTETUESEN, PARTITË E TJERA KËRKOJNË MARRËVESHJE POLITIKE

Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur të konstituohet as në përpjekjen e 34-të, duke thelluar edhe më shumë krizën institucionale që e ka mbërthyer vendin që nga zgjedhjet e 9 shkurtit. Edhe të enjten, sikurse në tentimet e mëparshme, nuk pati konsensus ndërmjet partive politike për ta zgjedhur kryetarin e Kuvendit dhe për ta vazhduar formimin e institucioneve të reja. Ata do të mblidhen sërish pas 48 orësh, përkatësisht të shtunën, më 21 qershor

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Për herë të 34-të deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë dështuar ta konstituojnë përbërjen e re parlamentare të dalë nga zgjedhjet e 9 shkurtit. Kjo është hera e 26 që Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lista Serbe nuk propozojnë nga një anëtar për formimin e komisionit për votim të fshehtë për kandidaten e Vetëvendosjes, Albulena Haxhiu, për kryetare të Kuvendit, megjë Haxhiu nuk ka arritur t'i marrë 61 votat e domosdoshme në votimin e hapur. Ata do të mblidhen sërish pas 48 orësh, përkatësisht të shtunën, më 21 qershor. Pas seancës, deputetë të Lëvizjes

Vetëvendosje thanë se janë në pritje të vendimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me ndryshimin e votimit për kryeparlamentar. Albulena Haxhiu, kandidatja e LV-së për kryeparlamentare, tha se që pesë javë është dërguar lënda në Kushtetuese dhe gjykata "është vonuar" të nxjerrë një vendim. Ajo tha se çështja e parashtruar është "e thjeshtë" dhe se Kushtetuesja ose duhet të pranojë ta trajtojë çështjen ose ta shpallë të papranueshme. Haxhiu shtoi se nëse partitë nuk e pranojnë rezultatin e zgjedhjeve, atëherë vendi duhet të organizojë zgjedhje të reja. Por, për këtë, po ashtu, kërkohet që fillimisht Kuvendit të konstituohet. Edhe Artan Abrashi nga kjo parti shpreh të njëjtin mendim. Ai u pyet për kërkesën e partive të tjera që zhblllokimi i Kuvendit të

bëhet përmes një marrëveshjeje politike, por ai tha se "inatet politike" po e mbajnë peng Kuvendin. Duke komentuar një takim mes kreut të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, dhe atij të Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, Abrashi tha se takimet e tilla nuk po kanë rezultat. "Nëse ka rezultat [nga takimet e udhëheqësve politikë] është mirëmbajtja e bllokadës", tha ai. Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, i ka fajësuar deputetët e ish-opozitës se nuk po duan të konstituohet Kuvendi. "Në këtë frymë më lejoni që deputetët opozitarë, të cilët nuk po duan që Kosova të ketë Kuvend, pra që ata të kenë shtëpi, t'i quaj deputetë nomadikë. Nomadët janë ata të cilët nuk dëshirojnë të kenë shtëpi. Mund të dëshirosh të kesh shtëpi dhe të mos kesh shtëpi e të jesh refugjat, ta zëmë, por ata të cilët nuk duan të kenë shtëpi, janë nomadë. Ky është thelbi i nomadit. Prandaj këta janë deputetë nomadikë, të cilët nuk dëshirojnë të kenë shtëpi të tyre, sepse shtëpia - Kuvendi, Parlamenti i Republikës - është shtëpia e deputetëve, sidomos e opozitarëve", ka deklaruar Kurti, duke shtuar se, pavarësisht se qeveria ka kompetenca të kufizuara, nuk do të thotë se kanë më pak punë. "Në

ndërkohë, Qeveria e Republikës së Kosovës njëmend i ka kompetencat e kufizuara, por nuk kemi më pak punë. Ne kemi më pak kompetenca. Dhe ndërmjet Kurtit 2 dhe Kurtit 3, e kemi këtë qeveri në detyrë, që është qeveri në tranzicion - le ta quajmë Kurti 2.5", ka pohuar Kurti. Ai këto komente i bëri në Podujevë gjatë vënies së gurthemelit për pishinën gjysmolimpike, disa orë para seancës konstitutive të Kuvendit, e cila dështoi sërish. Deputeti i PDK-së, Altin Krasniqi, ka thënë se në asnjë vend demokratik deputetët nuk votojnë me imponim. Ai ka theksuar se nëse partia e parë pretendon se i ka votat për ta formuar qeverinë, atëherë pyetja është: pse po e mban të bllokuar vendin. "Vetëm në regjime autoritare votimet ndodhin nën diktat. Nëse partia e parë ka nevojë për votat e partive ish-opozitare, ato sigurohen përmes marrëveshjes, jo përmes imponimit. Nëse partia e parë pretendon se i ka votat për ta formuar qeverinë, atëherë pyetja është: pse po e mban të bllokuar vendin? Kjo është një sjellje e papërgjegjshme, me pasoja për shtetin. Për interesa të ngushta partiake, Vetëvendosja po e

mban peng vendin, po vonon institucionet dhe po e thellon krizën. Prandaj, është detyrë qytetare dhe politike të kërkojmë llogari nga Vetëvendosja, e cila prej tre muajsh nuk ka ndërmarrë asnjë hap serioz për zgjidhjen e ngërçit institucional", ka thënë Krasniqi. Fatmir Limaj, para nisjes së seancës, tha se takimi me Abdixhikun ishte "i mirë" dhe "shterues", duke theksuar se me udhëheqësin e LDK-së ka biseduar për çështje politike, ekonomike, të sigurisë dhe për zhvillime në rajon dhe botë. Limaj tha se do të takohet sërish me Abdixhikun, por shtoi se bllokada në Kuvend "nuk zhbllkohet nëse nuk ka një marrëveshje politike". Lutfi Haziri nga LDK-ja insistoi në propozimin e paraqitur nga partia për një qeveri të unitetit. Ai tha se nga situata nuk mund të dilet pa një marrëveshje politike. "Çështjet politike dhe zgjedhjet e organeve deri në konstituim, s'mund të zgjidhen me procedura, por me marrëveshje politike", tha ai. Ndërkaq kreu i AAK-së, Ramush Haradinaj, tha se kryeministri në detyrë, Albin Kurti, po e mban "peng" vendin. Lëvizjes Vetëvendosje, që është fituese e zgjedhjeve, i takon ta

KOMANDANT JASHARI MERR MBËSHTETJE NË PENTAGON PËR ZHVILLIMIN E FSK-së



PRISHTINË, 19 QERSHOR - Komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Bashkim Jashari, ka marrë mbështetje në Pentagon për zhvillimin e mëtejshëm të FSK-së dhe bashkëpunimin në

misione të përbashkëta paqeruajtëse gjatë vizitës së tij zyrtare në Shtetet e Bashkuara. Gjeneral Jashari ka takuar drejtorin e Strategjisë, Planeve dhe Politikave në Shtabin e

Përbashkët të ushtrisë së ShBA-së, Joseph McGee, të cilin e ka informuar për arritjet e FSK-së, përfshirë pjesëmarrjen në Defender Europe '25, trajnimet me ushtrinë amerikane dhe

përgatitjet për dislokimin në Joint Readiness Training Center. “Gjenerallejtënant McGee e përgëzoi FSK-në për progresin, falënderoi për mikpritjen gjatë UF DE25, si

dhe konfirmoi mbështetjen e Pentagonit për zhvillimin dhe bashkëpunimin në misione të përbashkëta paqeruajtëse”, thuhet në njoftim. Në kuadër të vizitës, komandant Jashari ka takuar edhe shefin e Byrosë së Gardës Kombëtare të ShBA-së, Steven S. Nordhaus, dhe komandantin e Gardës Kombëtare të Iowas në JRTC, Steven Osborn, ndaj të cilëve ka shprehur mirënjohje për mbështetjen në procesin e trajnimeve dhe përgatitjeve për misionin e dislokimit. “Këto takime pasqyrojnë përparimin e qëndrueshëm të FSK-së drejt kapaciteteve të plota operacionale dhe theksojnë partneritetin strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në promovimin e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare”, thuhet në njoftim. FSK-ja është në proces të transformimit në ushtri të plotë që nga viti 2018. Ky proces pritet të zgjasë dhjetë vjet. Gjithashtu, gjatë transformimit ushtria e Kosovës pritet ta dyfishojë numrin e forcave të saj dhe të bëhet një ushtri mbrojtëse prej 5 000 trupash.

HASANI: KURTI DHE KABINETI I TIJ, UZURPUES TË PUSHTETIT QË PREJ SE JANË BETUAR DEPUTETË

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, ka folur për krizën e gjatë të moskonstituimit të Kuvendit e për kushtetutshmërinë e vendimeve të Albin Kurtit kryeministër në detyrë. Në emisionin “Rubikon” të Klan Kosovës, Hasani ka deklaruar se nuk është pritur që pas zgjedhjeve sistemi institucional të degjenerojë deri në këtë pikë. “Pas certifikimit të zgjedhjeve nuk kanë qenë të dukshme ravigëzimet e kësaj situatë çfarë po ndodh meqenëse, siç thotë populli, dreqi s’kujtohet kështu. Ka qenë diçka që s’është pritur se mund të kanalizohet në këtë mënyrë dhe të degjenerojë në këtë sistem”, ka thënë ai. Hasani e ka quajtur uzurpim të pushtetit sistemin ekzekutiv në

Kosovë nga Albin Kurti e kabineti i tij që prej kohës kur janë betuar deputetë të zgjedhur të legjislaturës së nëntë. Ai thotë se është e qartë se pushteti duhet të dorëzohet me automatizëm kur certifikohesh deputet. “Shenjat e para kanë qenë rreth mbajtjes së pozitës ekzekutive dhe postit të deputetit. Është tërësisht joligjore e jokushtetuese dhe përbën uzurpim të pushtetit. Pa asnjë diskutim, të gjithë janë uzurpues të pushteteve ekzekutive, sepse aty thuhet se me automatizëm duhet të dorëzohet detyra kur bëhet deputet. Uzurpim në sistemin ku sundon Kushtetuta e ligji quhet çdo mbajtje e ushtrim i autoritetit publik që nuk ka bazë juridike. Kjo është kështu. Pastaj është faza e dytë e degjenerimit të procesit, në momentin kur pa prituri e pa



kujtuar është ndërruar rendi i ditës, që është tërësisht joligjor. Gjërat e procesit të formimit të

Kuvendit janë sqaruar mjaft bukur në aktgjykimin e vitit 2015, saqë interpretimet që

bëhen tash janë interpretime absolutisht malicioze”, ka theksuar Hasani.

propozojë kandidatin për kryeparlamentar. Ky subjekt insiston se Haxhiu është personi i duhur për ta udhëhequr organin ligjvënës. Por, për PDK-në dhe AAK-në, Haxhiu konsiderohet figurë përçarëse, prandaj kërkojnë nga partia e Albin Kurtit ta ndryshojë kandidatin. Çështja e ndryshimit të mënyrës

së votimit - nga e hapur në të fshehtë - është dërguar për interpretim në Gjykatën Kushtetuese nga partitë që në legjislaturën e kaluar ishin në opozitë. Sipas tyre, propozimet e LV-së nuk janë kushtetuese dhe kanë kërkuar nga Gjykata të vendosë “një masë të përkohshme për ndalimin e mbajtjes së seancave, derisa me

prioritet ta trajtojë këtë lëndë dhe të marrë një vendim”. Teksa vendi ka mbetur pa institucione të reja për mbi katër muaj që nga mbajtja e zgjedhjeve, së voni LDK-ja - që doli e treta në zgjedhje - ka paraqitur një plan me 15 pika për një qeveri uniteti, duke i ftuar të gjitha partitë që ta formojnë një ekzekutiv të tillë në

mënyrë që vendi të dalë nga kriza. Ky propozim është refuzuar nga LV-ja, ndërsa PDK-ja dhe AAK-ja kanë thënë se pëlqejnë formimin e një qeverie me partitë që mandatin e kaluar ishin në opozitë. Por, çështja nuk mund të kalojë te zgjedhja e Qeverisë së re të Kosovës pa u konstituuar Kuvendi. Seanca për

konstituimin e Kuvendit ka nisur më 15 prill dhe deputetët duhet ta zgjedhin kryetarin dhe pesë nënkryetarët - për të cilët kërkohej 61 vota - në mënyrë që më pas të hapet rruga për formimin e ekzekutivit. Faktori ndërkombëtar u ka bërë thirrje ligjvënësve që sa më shpejt t'i formojnë institucionet e reja.

Agjencia e Menaxhimit Emergjent bën thirrje për kujdes: Mos ndizni zjarre!

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Agjencia e Menaxhimit Emergjent u ka bërë thirrje qytetarëve të Kosovës të tregojnë kujdes të shtuar gjatë stinës së verës, e cila karakterizohet me temperatura të larta dhe rrezik të shtuar për zjarre. AME thekson se zjarret në

pyje, fusha dhe hapësira të hapura shkaktojnë dëme të mëdha materiale, ndotin ajrin, shkatërrojnë natyrën dhe rrezikojnë jetën dhe sigurinë e qytetarëve. AME rikujton se zjarrvëniet janë vepër penale. “Vlen të theksohet dhe t’u bëhet e ditur se zjarrvëniet e

qëllimta, si dhe ato të shkaktuara nga pakujdesia, janë vepra penale të cilat sanksionohen me ligj. Çdo person që shkakton zjarr, duke dëmtuar pronën publike apo private, ose duke rrezikuar jetën e qytetarëve dhe mjedisin, përballlet me ndjekje penale dhe masa

ndëshkuese sipas legjislacionit në fuqi”, thuhet në njoftim. AME njofton qytetarët se nëse hasin në ndonjë zjarr, dyshojnë për zjarrvënie të qëllimshme ose vërejnë tym apo flakë në zona të hapura, t’i thërrasin shërbimet emergjente falas në çdo kohë.



PËR HERË TË PARË MBAHET SEANCË GJYQËSORE PËRMES VIDEOLIDHJES



PRISHTINË, 19 QERSHOR - Të enjten, në bashkëpunim në mes të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, është mbajtur për herë të parë seanca gjyqësore përmes videolidhjes. I burgosuri nga Qendra e Paraburgimit në Gjilan është paraqitur përmes videolidhjes, ndërsa gjyqtarja Fatime Dermaku ka udhëhequr seancën nga ambientet e Gjykatës Themelore në Prishtinë. “Kjo mënyrë e mbajtjes së

seancave gjyqësore përmes videolidhjes synon lehtësimin e procesit gjyqësor, duke zvogëluar nevojën për transport fizik të të burgosurve drejt gjykatave, duke rritur sigurinë dhe efikasitetin në procedura. Për realizimin e kësaj seance janë përdorur pajisje të avancuara audio dhe video për incizimin dhe regjistrimin e seancave gjyqësore. Këto pajisje, janë dhuruar nga Byroja për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL), do të ndihmojnë

në lehtësimin e punës së Shërbimit Korrektues dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në fushën e drejtësisë”, thuhet në njoftimin e ShKK-së. Sipas tyre, ky është një hap i rëndësishëm drejt modernizimit të sistemit korrektues dhe drejtësisë në vend, duke kontribuar në rritjen e sigurisë gjatë procedurave gjyqësore dhe duke përmirësuar qasjen e të burgosurve në proceset gjyqësore në mënyrë më efikase dhe të sigurt.

KOSOVA NDERON ISH-KRYETARIN E GJND-së

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka urrear profesorin japonez Hisashi Owada për pranimin e titullit “Doctor Honoris Causa” nga Universiteti i Prishtinës, duke shprehur mirënjohje për kontributin e jashtëzakonshëm që ai ka dhënë për të drejtën ndërkombëtare në përgjithësi dhe për të drejtën e Kosovës për pavarësi. Kryeministri Kurti përmendi rolin e tij si kryetar i Gjykatës

Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND), veçanërisht në procesin historik të vitit 2010, kur GjND-ja nxori opinionin këshillimor në lidhje me ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. “Ekspertiza e tij ishte thelbësore në opinionin e GjND-së në vitin 2010, i cili konfirmoi se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk përbënte shkelje të së drejtës ndërkombëtare. Ne mbetemi thellësisht mirënjohës për

përkushtimin e tij ndaj drejtësisë”, ka shkruar ai në “Facebook”. Në ceremoninë solemne të mbajtur në Amfiteatrin e Fakultetit të Edukimit të mërkurën, Universiteti i Prishtinës i akordoi titullin e lartë “Doctor Honoris Causa” profesorit Owada për kontributin e jashtëzakonshëm akademik si dhe për angazhimin jetësor në fushën e drejtësisë ndërkombëtare dhe promovimin e paqes globale.



‘FRUTEX’-I INSTALON 1200 KWH PANELE SOLARE PËR TA RRRITUR EFIKASITETIN ENERGJETIK



PRISHTINË, 19 QERSHOR - Kompania “Frutex” ka bërë një hap të rëndësishëm drejt energjisë së qëndrueshme, duke realizuar një investim të madh në fushën e energjisë së ripërtërishme. Në ambientet e saj janë instaluar panele solare me kapacitet total prej 1200 kWh. Ky projekt ka për qëllim jo vetëm rritjen e efikasitetit energjetik të kompanisë, por

edhe zvogëlimin e ndikimit mjedisor që shkaktohet nga përdorimi i burimeve tradicionale të energjisë. Sipas kompanisë, me këtë sistem tashmë mbulohen rreth 30 për qind e nevojave të tanishme për energji elektrike. Nga “Frutex” kanë bërë me dije se synimet për të ardhmen janë edhe më ambicioze. Ata planifikojnë t’i zgjerojnë kapacitetet e

prodhimit të energjisë solare në mënyrë që në vitet e ardhshme një pjesë edhe më e madhe e konsumit të energjisë të mbulohet nga burimet e ripërtërishme. Kompania “Frutex” njihet për aktivitetin e saj në industrinë ushqimore dhe pijeve, ndërsa me këtë investim tregon angazhimin për zhvillim të qëndrueshëm dhe përgjegjësi ndaj mjedisit.

Hajrulla Çeku, kandidat i LV-së për kryetar të Prishtinës

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje për kryetar të Prishtinës në zgjedhjet lokale të tetorit do të jetë Hajrulla Çeku, aktualisht ministër në detyrë i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, gjithashtu deputet i

zgjedhur në legjislaturën e re të Kuvendit të Kosovës. “Në mënyrë unanime, qendra e Prishtinës zgjodhi të jetë kandidat për kryetar nga LV-ja, Hajrulla Çeku”, ka thënë Arben Vitia, kryetar i Degës së LV-së në

Prishtinë, ndërsa disa aktivistë të partisë kanë shkruar në rrjete sociale “Hajr Prishtinës”. Partitë politike në Kosovë kanë filluar përgatitjet për zgjedhjet e ardhshme lokale, të cilat janë planifikuar të mbahen më 12

tetor. E beteja komunale pritet të jetë e ashpër, duke qenë se ajo përfaqëson një shans për ta konsoliduar bazën elektorale dhe vlerësohet si matëse e fuqisë politike pas zgjedhjeve të fundit parlamentare.



UDHËHEQJA E OVLUÇK-së TAKOHET ME DEPUTETË ZVICERANË: GJYKATA SPECIALE PO VEPRON NË MËNYRË TË PADREJTË



EPOKA ERE **Mal QORRAJ**

BERN, 19 QERSHOR - Kryetari i OVLUÇK-së, Hysni Gucati dhe nënkryetari Gazmend Sylja, kanë vizituar Parlamentin e Zvicrës. Ata kanë takuar deputetin zviceran Reto Nause, një mik i respektuar i lirisë dhe demokracisë. Gjithashtu, janë

Parlamentin e Zvicrës, realizuam një takim të rëndësishëm me deputetin zviceran, Reto Nause, një mik i respektuar i lirisë dhe demokracisë, si dhe me deputetë të tjerë të pranishëm. Në emër të të gjithë veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, falënderuam z. Nause për pritjen e ngrohtë dhe

do të ndalemi. Do të trokasim në çdo derë, deri sa të ndalet ky proces i padrejtë dhe të rikthehet drejtësia”, ka shkruar Gucati. Ai ka thënë se ky takim përfaqëson një hap të rëndësishëm në përpjekjet e tyre për ta ngritur zërin në arenën ndërkombëtare, duke kërkuar drejtësi dhe respekt për ata që

në Gjykatën Speciale kundër bashkëluftëtarëve tanë, njerëz që sakrifkuan gjithçka për lirinë që sot e gëzon Kosova”, ka shkruar Sylja. Edhe veprimtari Sali Bislimi ka shkruar për takimin e udhëheqjes së OVLUÇK-së në Parlamentin e Zvicrës. “Një nder me krenari për UÇK-në sot në parlamentin zviceran, kënaqësi

gjykatë politike. Gazmend Sylja nënkryetari me cilësi të një ushtari të denjë, i cili në çdo moment ishte i gatshëm të bënte një sqarim mbi të kaluarën dhe të tashmen e Kosovës”, ka shkruar Bislimi në “Facebook”. Bislimi ka theksuar se: “Kosova ka mikun historik të saj në parlamentin zviceran, njeriun e sigurisë z. Reto Nause, i cili në



takuar edhe me deputetë të tjerë të Parlamentit të Zvicrës. Ata në këtë vizitë në Parlamentin e Zvicrës shoqëroheshin nga veprimtari Sali Bislimi, i cili jeton dhe vepron në këtë shtet. Gucati në “Facebook” ka thënë se në këtë takim u diskutuan edhe çështje të tjera si lufta e Kosovës ndaj Serbisë, situata politike aktuale në Kosovë dhe padrejtësitë e mëdha që po u bëhen krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Hagë nga Gjykata Speciale. “Në

mundësinë që na dha për të ngritur shqetësimet tona lidhur me trajtimin e ish-bashkëluftëtarëve tanë që gjenden në Dhomat e Specializuara në Hagë. Në këtë takim, u diskutuan edhe çështje të tjera si lufta e Kosovës ndaj Serbisë, situata politike aktuale në Kosovë dhe padrejtësitë e mëdha që po u bëhen krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Hagë nga Gjykata Speciale. Kjo gjykatë po vepron në mënyrë të padrejtë, por ne nuk

dhanë gjithçka për lirinë e popullit tonë. Për këtë takim në “Facebook” ka shkruar edhe nënkryetari i OVLUÇK-së, Gazmend Sylja. “Pasi dera e parlamentit tonë ka mbetur e mbyllur për ne, luftëtarët e lirisë po trokasim atje ku ka gatishmëri për të dëgjuar zërin tonë. Sot u takuam me deputetin zviceran z. Reto Nauser dhe deputetë të tjerë të Parlamentit të Zvicrës, të cilëve ua paraqitëm shqetësimet tona për padrejtësitë që po ndodhin

ta organizojë dhe t'i shoqërojë Hysni Gucatin kryetar i OVLUÇK-së, njeriu që i dha pjesë të trupit atdheut, sot me ofshamat e dhimbjes u ngjitë shkallëve të parlamentit për të thënë të vërtetën miqve tanë: dhimbjen, krenarinë për lirinë dhe shtetndërtimin e Kosovës, padrejtësinë e një procesi të padrejtë të Hagës kundër bijve më të çmuar të historisë së Kosovës - presidentin Hashim Thaçi dhe gjithë të tjerëve që gjinden prapa grilave në një

çdo kohë është i gatshëm për t'i nderuar dhe respektuar ata që deshën mi falë jetën Kosovës për lirinë e saj”. “Ishte nder edhe takimi edhe me tre deputetë të tjerë z. Martin Candinas ish-kryetar i parlamentin vitin që shkoi, Jacques Nicolet dhe Alois Huber. Mua edhe Retos na dhanë nga një shenjë me emblemën e UÇK-së për t'i kujtuar sakrificat mbi njerëzore kundër një pushtuesi barbar serb që kishte Kosova”, ka shkruar Bislimi.



Komuna e Rahovecit merr vlerësim të mirë nga ZKA-ja sa i përket menaxhimit të financave

RAHOVEC, 19 QERSHOR - Komuna e Rahovecit zyrtarisht ka pranuar raportin nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA). “Me kënaqësi ju njoftoj se Komuna e Rahovecit ka pranuar raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2024, me opinion të pamodifikuar, që do të thotë se të gjitha aspektet materiale të financave tona janë në përputhje me ligjet dhe standardet ndërkombëtare të

auditimit. Ky është një vlerësim shumë i rëndësishëm tonë ka qeverisje të mirë, transparente dhe të përgjegjshme”, ka shkruar në “Facebook” kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi. Ai ka thënë se kjo arritje nuk do të ishte e mundur pa angazhimin dhe përkushtimin e ekipit të tij, të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, të drejtorëve të drejtorive, të

administratës komunale, si dhe pa bashkëpunimin e mirë me qytetarët. “Falënderoj secilin prej jush për kontributin dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm! Po ashtu, falënderoj për bashkëpunimin e mirë edhe ekipin e auditorëve nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), të cilët e kanë kryer këtë proces me profesionalizëm të lartë dhe transparencë të plotë. Ky

sukses na jep shenja të qarta se kemi mundësi reale të jemi përfitues të Grantit të Performancës, që është një burim shumë i rëndësishëm financiar për realizimin e projekteve në shërbim të qytetarëve tanë. Kemi një përkushtim serioz dhe të palëkundur për të ndërtuar një administratë edhe më të përgjegjshme, çdo ditë e më të hapur dhe sa më efikase, në shërbim të qytetarëve dhe



në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të komunës sonë”, ka thënë Latifi.

ADMINISTRIMI I TOKËS, GARANTUES I SIGURISË LIGJORE PËR PRONËN

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Është mbajtur takimi i Komitetit Ndërmëtor për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturës Kombëtare për Informacionin Hapësinor në Republikën e Kosovës. Në këtë takim u diskutuan hapat strategjikë për administrimin e tokës dhe rëndësia e infrastrukturës hapësinore për zhvillimin ekonomik dhe ligjor të vendit.

Zëvendësministri i Ekonomisë, Getoar Mjeku, ka theksuar rëndësinë e angazhimeve të Komitetit që nga themelimi i tij në vitin 2022. “Tashmë kemi mbajtur një sërë mbledhjesh të rëndësishme, andaj është me rëndësi të vazhdojmë t’i

kryejmë detyrat që kemi përpara, veçanërisht identifikimin e politikave dhe çështjeve strategjike”, ka pohuar ai. Ndërsa sekretari i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Izedin Bytyqi, vuri në pah dimensionet e shumta që përfshin administrimi i tokës. “Administrimi i tokës nuk është vetëm çështje teknike, por edhe çështje ekonomike dhe sociale. Është edhe garantues i sigurisë ligjore për pronën, edhe mjet i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe mirëqenies qytetare. Pa sistem të mirëfilltë të administrimit të tokës nuk mund të kemi planifikim të



drejtë e zhvillim të barabartë apo qasje të drejtë”, ka thënë Bytyqi.

Ai ka bërë me dije se Kosova tashmë është në fazën e zbatimit të një prej projekteve më madhore të dekadës së fundit. “Sot jemi në fazën e zbatimit të një prej projekteve

më madhore dhe gjithëpërfshirëse të dekadës së fundit: projektit të ndërtimit të kadastrës që po realizohet në 115 zona kadastrale në 32 komuna të Kosovës. Ky projekt është duke u zhvilluar me ritëm të lartë”, ka thënë ai.

Ndërsa drejtori ekzekutiv i

Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Avni Ahmeti, ka vlerësuar përparimin në aspektin legjislativ dhe tekniko-praktik të reformës kadastrale. “Ndryshimi sa i përket sistemit për kadastrën, hyrja në fuqi edhe e udhëzimeve administrative në bazë të këtyre reformave, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka nxjerrë edhe dy udhëzues të punës: udhëzuesin për matjen, ndryshimin dhe regjistrimin e njësive kadastrale në sistemin kadastral në Kosovë, gjithashtu edhe udhëzuesin për rindërtimin e informacioneve kadastrale”, ka thënë Ahmeti, duke shtuar se këtë vit ritmi i punës është shumëfishuar.

PAS 1 KORRIKUT NJË KAFE MUND TË KUSHTOJË DERI NË TRI EURO

Prishtinë, 19 qershor - Afaristi Ragip Mustafa ka ngritur alarmin se pas 1 korrikut Kosova do të pësojë çrregullim ekonomik si pasojë e liberalizimit të tregut energjetik.

Mustafa ka thënë për “RTV21” se nga tregu i hapur energjetik do ta pësojnë më së shumti qytetarët në Kosovë të cilët do të paguajnë çdo produkt më shtrenjtë sesa që është aktualisht. “Nuk po tregohet se rritja nuk do të bëhet veç për bizneset. Kjo rritje e çmimit të rrymës do t’i prekë të gjithë



qytetarët. Ata do të paguajnë shportën e konsumit shumë më shtrenjtë sesa që po paguajnë aktualisht. Çmimet veçse kanë filluar të rriten. Pas 1 korrikut një kafe do të mund të kushtojë deri në 3 euro”, ka thënë Mustafa.

Afaristi Mustafa, duke folur për përvojën e tij me tregun e hapur energjetik në shtetin e Shqipërisë, ka thënë se atje janë 5 ose 6 kompani të cilat ofrojnë energji elektrike. “Atje që 3 ose 4 vjet është i hapur tregu, por janë disa kompani, 5 ose 6, e këtu është krijuar

monopol dhe një kompani e vetme ta shet rrymën sa të dojë. Unë në Shqipëri kam investuar dhe do të investoj prapë. Edhe tash, pas konsultave me 5-6 kolegë, vetëm kemi filluar të tërhiqemi nga Kosova. Ka pengesa të mëdha dhe veç i kemi nisur investimet në Shqipëri, Greqi dhe Gjermani”, ka thënë ai. E metë tjetër e madhe për bizneset në Kosovë vazhdon të jetë mungesa e fuqisë punëtore, e cila pas liberalizimit të vizave është përkeqësuar.

AUVK kërkon kujdes të shtuar të fermerëve në Kosovë, pas mortajës së dhenve dhe dhive në Shqipëri

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës, duke marrë parasysh shpërthimin e sëmundjes PPR (Mortaja e Dhenve dhe Dhive) në disa zona të Shqipërisë, bën thirrje për kujdes të shtuar nga fermerët në zonat kufitare të Republikës së Kosovës. “Për të parandaluar përhapjen e

sëmundjes në territorin tonë, kërkojmë që: Të evitoni çdo kontakt të drejtpërdrejtë të deleve dhe dhive me kafshë të ardhura nga territori i Shqipërisë; Të mbani kafshët tuaja të monitoruara; Të raportoni menjëherë te veterineri zyrtar çdo shenjë të dyshimtë të sëmundjes (ethet e larta, plagë në gojë, hundë

ose sytë që rrjedhin, dobësi të përgjithshme); Të mos lejoni futjen e kafshëve tjera në tufat tuaja. Zbatimi i këtyre masave është thelbësor për mbrojtjen e tufave tuaja dhe parandalimin e përhapjes së sëmundjes në Kosovë”, thuhet në njoftimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë të Kosovës.



FATI I IRANIT DO TË SHKRUHET NGA VETË IRANIANËT

“A mendon se do ta shoh ndonjëherë përsëri Iranin?”

Pyetja mbetet pezull në ajër – e qetë, e brishtë, e rëndë, plot mall. Im atë e bën atë në muzg të jetës së tij, teksa lufton me kancerin që përpiqet ta vërë përfund. Nuk është vetëm zëri i tij që dëgjoj, por jehona e miliona të tjerëve: atyre që u detyruan të iknin nga toka që donin, dhe atyre që mbetën pas, dhe që ende janë duke pritur ditën kur Irani mund të bëhet sërish... Iran.

Ai iku drejt Londrës pas revolucionit të vitit 1979, duke i shpëtuar për pak litarit të një teokracie që zëvendësoi një monarki të rrëzuar. Im atë i shërbeu kësaj monarkie me besnikëri, duke besuar se pavarësisht të metave si autokraci, ajo ishte modernizuese, shoqërisht liberale dhe politikisht e reformueshme: e kundërta e Republikës Islamike.

Që kur iku, ai nuk u kthye më kurrë në Iran. Në mërgim, u bë dëshmitar i një regjimi që burgosi, torturoi dhe vrau pa mëshirë. Një regjim që e shkëputi nga toka e tij, por që nuk arriti kurrë t'i shuante shpresën.

Po të tjerët? Ata që mbetën. Familjarët dhe të dashurit tanë. Ata që duruan kamxhikun e shtypjes dhe gati pesë dekada pasigurie të vazhdueshme. Edhe ata pyesin: Kur do ta rimarrim vendin tonë nga kjo natë e gjatë dhe e errët?

Unë u rrita mes nostalgjisë për një atdhe të humbur dhe realitetit të mërgimit. Thirrjet jashtë ambasadës së Republikës Islamike, zhurma e gotave të çajit persian në mbledhjet e disidentëve në banesat tona të vogla, lajmet për atentate dhe vrasje që na morën miq dhe ëndërrimtarë. Ajo përzierje rrëqethëse trishtimi dhe sfide na formësoi. Dhe tani, teksa lufta errëson horizontin, e ndjejmë sërish: dhimbje për të pafajshmit, shpresë për rënien e persekutorëve.

Kur flas me figura të shoqërisë civile brenda Iranit, duket se pak iranianë ia hedhin fajin drejtpërdrejt duarve të huaja për këtë luftë. Megjithëse çdo vend ka shumë zëra, shumë iranianë besojnë se Republika Islamike kurrë nuk ka qenë mbrojtëse e kombit, por vetëm e revolucionit të vet. Edhe Trupat e Gardës Revolucionare nuk mbajnë emrin e Iranit – por të një ideologjie të dhunshme që përpin bijtë e vet dhe u sjell atyre luftë.

Në një deklaratë të përbashkët, fitueset e çmimit Nobel Narges Mohammadi dhe Shirin Ebadi, regjisorët Jafar Panahi dhe



Mohammad Rasoulof, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile, i bënë thirrje liderëve botërorë të ndalin pasurimin e uraniumit dhe gjakderdhjen e të pafajshmëve në Iran dhe Izrael.

Brenda vendit, optimizmi dhe frika luftojnë për shpirtin e popullit. Për dekada, shumë prej nesh u bëmë thirrje liderëve botërorë: refuzoni njëkohësisht përkëdheljen dhe luftën ndaj Republikës Islamike. Kishte një rrugë tjetër – të izolohej regjimi dhe të fuqizohej populli. Pak e zgjodhën këtë. Shumë pyetën: “A duan vërtet iranianët ndryshim?” – sikur nuk i dëgjonin protestuesit iranianë të thërrisnin “Vdekje diktatorit” dhe “Vdekje Khamenei-t” në rrugë. Ndoshta tani – teksa këto thirrje jehojnë nga çatitë e Teheranit, edhe në kohë lufte – do t’i dëgjojnë më në fund.

Që prej nisjes së përplasjes, disa prej arkitektëve të terrorit të regjimit janë vrarë në bunkerë e krevate. Por bashkë me ta janë

vrarë edhe një poet, një sportist, dhe fëmijë – premtimi i ndritur i së nesërme që shuhet bashkë me errësirën e të vjetrës. Shumë prej nesh e shohin me dhimbje se si bashkëkombësit tanë braktisin shtëpitë, të dëshpëruar për një strehë larg shtypjes dhe shkatërrimit. Siç pyet reperi disident Toomaj Salehi: “Si mund të evakuhon mbi 9 milionë njerëz – pa karburant, shpesh pa kursime të mjaftueshme për të lëvizur, dhe pa një shtëpi të dytë në një qytet tjetër?”

Iranianët e shohin hipokrizinë e dhimbshme të zyrtarëve të regjimit që sot derdhin lot për civilët, ndërkohë që në vitin 2019 vranë 1,500 protestues, më shumë se 500 të tjerë gjatë kryengritjes “Grua, Jetë, Liri” të vitit 2022, dhe shumë të tjerë gjatë katër dekadave të tiranisë. Megjithatë, regjimi vazhdon të kapet pas skenarit të tij autoritar: mbyll internetin, censuron lajmet. Në vend që t’u ofrojë qytetarëve siguri dhe mbrojtje gjatë luftës, i detyron


studentët të japin provime sikur asgjë nuk ka ndodhur, dhe shton shtypjen e fjalës së lirë. Mungesa e legjitimitetit të Republikës Islamike nuk shfaqet vetëm në shkeljet mizore të të drejtave të njeriut, por edhe në dështimet strategjike. Siç thotë Kylie Moore-Gilbert: “Duke shtypur kundërshtimet, burgosur të pafajshmit, dhe dështuar në operacione jashtë vendit – Iranit nuk i ecën më asgjë.” Së fundmi, spiunët dhe pilotët izraelitë kanë arritur të dëmtojnë seriozisht aftësitë kundërpërgjigjëse të Iranit. Të gjithë ata që besojnë vërtet në paqen, e refuzojnë si luftën agresive, ashtu edhe terrorin në çdo formë. Mospërfillja ndaj njërës i shkatërron themelet tjetrës.

Asnjë fuqi e jashtme nuk do ta shpëtojë Iranin. Epoka e shpëtimtarëve të huaj ka marrë fund. Nuk jetojmë më në botën e perandorive unike apo aleancave të thjeshta. Çdo komb duhet të kujdeset për

kopshtin e vet. Por asnjë tokë nuk është e shkëputur. Për gati një gjysmë shekulli, regjimi në Iran ka helmuar më shumë se tokën e vet – infeksioni i tij është përhapur në Jemen, Siri, Irak, Gaza, Liban.

Fati i Iranit do të shkruhet nga vetë iranianët – jo në kryeqytete të huaja apo në dhoma të mbyllura, por në rrugët e tyre, me zërat e tyre dhe përmes përpjekjes së tyre. Dhe për sa kohë ata që ëndërrojnë një demokraci liberale mbeten të përçarë, për sa kohë ambiciet personale, plagët e vjetra dhe ndarjet ideologjike pengojnë një qëllim të përbashkët – e kam frikë përgjigjen ndaj pyetjes së tim eti.

Për hir të një Irani të lirë, një rajoni të qëndrueshëm dhe një bote në paqe – teksa kërkojmë përmbajtje dhe respektim të së drejtës ndërkombëtare – duhet të sigurojmë gjithashtu sovranitetin e popullit iranian, jo të shtypësve të tij. / TIME – Bota.al



Sejdiu emërohet trajner i Trepçës '89

Gani Sejdiu është emëruar trajner i skuadrës së Trepçës '89. Sejdiu me sukses e ka drejtuar në të kaluarën skuadrën mitrovicase sikurse edhe shumë klube të tjera të Kosovës, e

mitrovicasit besojnë se me trajnerin në fjalë do t'i arrijnë objektivat. "Klubi Futbollistik Trepça '89 ka kënaqësinë të njoftojë emërimin e Gani Sejdiut si

kryetrajner i ekipit tonë të parë. Me një përvojë të pasur në futbollin kosovar dhe një vizion të qartë për zhvillimin dhe suksesin e skuadrës, Gani Sejdiu rikthehet në

bankinën tonë për të udhëhequr një projekt të ri dhe ambicioz. Besimi ynë në profesionalizmin, përkushtimin dhe aftësitë e tij është i plotë - dhe jemi të bindur se

me të në krye, Trepça '89 do të ecë drejt objektivave madhore. Mirë se vjen në shtëpi, profesor! Bashkë drejt sukseseve të reja", thuhet në njoftimin e 89-shit.

Vendoset gurthemeli i pishinës gjysmolimpike në Podujevë



PODUJEVË, 19 QERSHOR - Podujeva po bëhet me pishinë gjysmolimpike. Gurthemeli i saj është vendosur sot në një ceremoni të organizuar në Ditën e Çlirimit të Podujevës. I pranishëm në vënien e gurthemelit ishte edhe kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, i cili tha se kjo pishinë do të bëhet një ambient i këndshëm për notarët e ata që e duan këtë sport. "Qytetarët kur të vijnë këtu do të kenë mjedis të këndshëm, mjedis në të cilin do të mund edhe ta kultivojnë shëndetin e tyre, të notojnë, por edhe të shoqërohen së bashku në një ambient publik i cili kujdeset për mirëqenien e qytetarëve", ka theksuar

kryeministri Kurti. Edhe kryetari i komunës, Shpejtim Bulliqi, tha se kjo pishinë do të krijojë kushte shumë të mira për sport dhe rekreacion. "Ky investim madhor, me vlerë prej 3,956,120.91 eurosh, financohet nga Ministria e Kulturës me afro 3.5 milionë euro dhe nga Komuna e Podujevës me 500 mijë euro. Pishina do të ndërtohet në një hapësirë prej 4,555.88 m² dhe do të përfshijë: Pishinën gjysmolimpike për not, pishinën për fëmijë si dhe hapësira përcjellëse për gastronomi dhe rekreacion. Urime, qytetarët e gëzofshin këtë projekt", u shpreh Bulliqi. Ai e falënderoi kryeministrin në detyrë Kurti dhe ministrin në

detyrë të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, për investimet që po i bëjnë në komunën e Podujevës. Ndërkohë, ministri Hajrulla Çeku tha se ky projekt është një shembull i mirë i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe uroi që punët për ndërtimin e tij të shkojnë sa më mirë që sportistët ta gëzojnë sa më parë. Në ceremoninë e vënies së gurthemelit të pishinës gjysmolimpike morën pjesë edhe zëvendësministria në detyrë e MKRS-së, Daulina Osmani, kryesuesi i Kuvendit Komunal, Hilmi Hoxha, nënkryetarja e komunës, Marigona Lahu, drejtorë dhe zyrtarë komunalë dhe qytetarë të Podujevës.

SHKURT

Dyfishohet vlera e Fisnik Asllanit

Fisnik Asllani ka përfunduar një sezon të shkëlqyer me Elversberg në Bundesliga 2, ku ishte i huazuar nga Hoffenheimi. Sulmuesi nga Kosova shkëlqeu me 19 gola dhe 10 asistime në 37 ndeshje zyrtare, duke qenë një nga lojtarët më të mirë në Bundesliga 2. Performanca e tij mbresëlënëse ka bërë që Transfermarkt t'ia dyfishojë vlerën nga 4 milionë në 8 milionë euro. Pas përfundimit të huazimit, Asllani është rikthyer te Hoffenheimi, klubi që zotëron kartonin e tij. Megjithatë, e ardhmja e tij mbetet e pasigurt, pasi interesimi për 22-vjeçarin është i madh. Werder Bremen, Fenerbahçe, Lille dhe Stuttgart janë ndër klubet që e kanë në listën e dëshirave. Në javët në vijim pritet të vendoset nëse Asllani do të qëndrojë te Hoffenheimi apo do të transferohet drejt një aventure të re.

Cialleshi po e mendon pensionimin

Sokol Cikalleshi, një prej emrave më të spikatur të sulmit kuqezi në dekadën e fundit, ka vendosur t'i japë fund karrierës si futbollist profesionist. Lajmi është mësuar nga burime të "Panorama Sport", që raportojnë se ky është vendimi aktual i sulmuesit kavajas, edhe pse një komunikim zyrtar ende nuk është bërë nga vetë lojtari. Cikalleshi e mbylli sezonin e fundit në Turqi, ku aktivizohej me skuadrën e Adanasporit, pjesë e ligës së dytë turke. Pas shumë vitesh karrierë mes Shqipërisë, Kroacisë, Turqisë dhe Arabisë Saudite, ku ka qenë pjesë e disa klubeve me peshë dhe ka qenë një emër i qëndrueshëm në listën e trajnerëve të Kombëtares, 34-vjeçari ka vendosur të mbyllë një kapitull të rëndësishëm të jetës së tij. Me 60 ndeshje dhe 13 gola të shënuar me fanellën kuqezi, Cikalleshi do të mbahet mend si një prej sulmuesve më të rëndësishëm të brezit të tij.

Fiorentina insiston për transferimin e Asllanit

Fiorentina nuk heq dorë nga transferimi i Kristjan Asllanit. Fiorentina ka bërë gati ofertën për mesfushorin shqiptar dhe së shpejti do ta kontaktojë skuadrën e Interit. Asllani pëlqehet nga trajneri i Fiorentinës, Stefano Pioli, që po insiston në transferimin e futbollistit të Kombëtares së Shqipërisë. 23-vjeçari ka kontratë deri në vitin 2028 me Interin, ekip që është i gatshëm ta shesë për ofertën e duhur. Fiorentina pritet të ofrojë deri në 20 milionë euro për Asllanin, i cili ka luajtur edhe për Empolin, kurse sezonin e fundit ka shënuar 3 gola dhe ka bërë 2 asistime në të gjitha garat.

Berisha konfirmon largimin nga Dukagjini, pritet t'i bashkohet Dinamos

KLINË, 19 QERSHOR - Futbollisti i njohur Hekuran Berisha ka konfirmuar largimin nga Dukagjini i Klinës. Berisha ka konfirmuar lajmin e largimit në "Facebook", derisa ka falënderuar klubin dhe njerëzit që e kanë ndihmuar në rrugëtimin e tij deri më tash. "Po e shënoj këtë mesazh me

plot emocione për Klubin KF Dukagjini! Faleminderit shumë për mbështetjen - familjes time, klubit dhe qytetit tim të zemrës - si dhe stafit, nga presidenti Fabian Veseli, Korab Desku e deri te kryetrajneri Ismet Munishi që më kanë mbështetur gjatë gjithë rrugës time deri ku jam sot. Kam

kaluar të gjitha gjeneratat e grupmohave në këtë klub, ku jam rritur si futbollist dhe si person me karakter. Kam qenë pjesë e një grupi shumë mbështetës dhe e ndiej Dukagjinin si shtëpinë time të dytë. Po largohem për të bërë një hap tjetër në karrierën time, por KF Dukagjinit, klubit ku jam

formuar, i uroj suksese të shumta gjatë gjithë rrugëtimin. Do ta keni përherë mbështetjen time", ka shkruar Berisha. Transferimi i tij te Dinamo City shihet si një hap i rëndësishëm për ta vazhduar rritjen profesionale dhe për ta sfiduar veten në një ambient të ri futbollistik.



Leclerc: Në Kanada humbëm një shans të mirë për podiumin

MONACO, 19 QERSHOR - Në një kampionat që deri më tani është karakterizuar nga epërsia e McLarenit, duhet të përfitosh nga çdo mundësi kur makina britanike gabon. Siç ndodhi në garën e fundit të Formulës 1, në Kanada, ku në podium u ngjitën dy Mercedes

dhe një Red Bull. Ai që zhgënjeu ishte Ferrari, ndaj për Charles Leclerc ky ishte një shans i shpërdoruar. Ndoshta jo edhe aq kur sheh se pilotët e “kokëkuqes” u nisën nga vendet larg kreut. Monegasku, që u rendit i pesti, shfaqësohet për këtë rezultat.

“Nuk dua të flas për ‘nëse’ apo ‘por’. U rendita i pesti dhe ndoshta nuk i kam bashkuar të gjitha pjesët dhe nuk e kam bërë punën time ashtu si duhet”, ka komentuar piloti i Ferrarit. “Mercedesi kishte avantazhin në atë fundjavë, Red Bulli është vazhdimisht

atje dhe McLaren ishte pak më në vështirësi. Unë mendoj se edhe ne ishim aty duke konkurruar, por e pamë se ku përfunduam”, ka thënë Leclerc. Me pak fjalë, Leclercu merr fajin për rezultatin zhgënjyes në Kanada. Piloti i Ferrarit, edhe në një fundjavë



të mërztishme, shënoi më shumë pikë se Lewis Hamiltoni, që u rendit në vendin e gjashtë.

Gattuso: Ta rikthejmë entuziazmin në kombëtare

ROMË, 19 QERSHOR - Genaro Gattuso është paraqitur këtë të enjte zyrtarisht si trajneri i përfaqësueses italiane të futbollit pas shkarkimit të Luciano Spalletit. Prezantimi u bë nga presidenti i Federatës, Gabriele Gravina. Vetë Gattuso u shpreh i emocionuar që do ta drejtojë përfaqësuesen “azzurre” pavarësisht momentit delikat në të cilën ndodhet kjo kombëtare: “Kjo është një ëndërr që bëhet realitet. Shpresoj të jem në lartësinë e duhur. E di që detyra nuk është e lehtë, por asgjë në jetë nuk është e lehtë. Unë dhe stafi im e dimë që ka shumë punë për të bërë, por kemi vetëdijen se mund të bëjmë një punë shumë të madhe. Prej vitesh dëgjoj që nuk ka talent, por unë mendoj se lojtarët ekzistojnë – thjesht duhet t’i vëmë në kushtet e duhura për ta shprehur maksimumin e tyre”. Më pas Gattuso u ndal të fliste për gjendjen e skuadrës dhe rrezikun për ta humbur mundësinë për ta munguar për herën e tretë me radhë në Kupën



e Botës. Ish-mesfushori u shfaq i qetë, teksa theksoi se skuadrës i duhet rikthyer entuziazmi: “Qëllimi është ta rikthejmë Italinë në Kupën e Botës – për ne dhe për futbollin tonë është diçka thelbësore. Duhet ta rikthejmë entuziazmin, të mos mendojmë në mënyrë negative. Kushdo që vjen në Coverciano duhet të vijë me entuziazëm – krijimi i një familjeje është gjëja më e rëndësishme. Përveç teknikës dhe taktikës, duhet të rikthejmë atë frymë grupi që për vite me radhë na ka dalluar në botë. Kam bindjen që kemi në dispozicion lojtarë të rëndësishëm – 4-5 prej tyre janë ndër 10 më të mirët në botë në rolet e tyre. Por, po e përsëris:

është fjala për skuadrën, jo për individët. Jam i bindur që skuadra ka vlera dhe mund ta arrijmë objektivin. Kur më telefonuan Buffoni dhe Gravina nuk hezitova asnjë sekondë. Besoj se kemi cilësitë për ta arritur qëllimin”. Në fund Gattuso u ndal të fliste edhe për problematikën e lojtarëve të huaj në kampionatin italian, numri i të cilëve po shtohet nga viti në vit gjithmonë e më shumë: “Ka një të dhënë që duhet të na bëjë të reflektojmë. Këtë vit në kampionatin italian kanë luajtur 68 % lojtarë të huaj dhe vetëm 32 % italianë. Në nivelin e të rinjve është bërë një punë shumë e mirë, por pas moshës U-19 lojtarët diku humbin rrugës. Duhet t’u japim më shumë hapësirë të rinjve. Tani ndryshimi ka të bëjë me faktin që të kemi më shumë të rinj në dispozicion. Ta veshësh fanellën e Kombëtares dhe të mos kualifikohesh dy herë radhazi në Botëror nuk është e lehtë, por nuk duhet të kemi frikë”, ka deklaruar Gattuso.

Shitet për 10 miliardë dollarë, Lakersi bën historinë me marrëveshjen më të madhe në sport

LOS ANXHELOS, 19 QERSHOR - Për herë të parë pas më shumë se 45 vjetësh familja Buss nuk do të jetë më pronarja në shumicë e Los Angeles Lakersit. Jeanie Buss dhe familja e saj kanë arritur marrëveshjen për ta shitur pjesën më të madhe të aksioneve te Mark Walterit, pronar kryesor i Los Angeles Dodgersit, për një shumë rekord prej 10 miliardë dollarësh, shuma më e lartë e paguar ndonjëherë për një ekip sportiv në histori. Mark Walter, CEO i TWG Global, tashmë do ta ketë kontrollin kryesor të një prej markave më ikonike në sportin botëror. Ai ka qenë aksionar minoritar për



disa vjet, por tani do t’i drejtojë lakersat në një epokë të re. Megjithatë, Jeanie Buss do të vijojë për momentin në rolin e guvernatores së ekipit, duke mbetur vendimmarrësja kryesore. Lakersat u blenë nga Jerry Buss në vitin 1979 për vetëm 67.5 milionë dollarë, një

shumë që përfshinte edhe ekipin e hokejit Los Angeles Kings dhe arenën Forum. Nën drejtimin e tij, klubi u kthye në një fuqi botërore, duke fituar 11 tituj kampionë dhe duke mbledhur “yje” si Magic Johnson, Kobe Bryant, Shaq O’Neal dhe aktualisht Le Bron James e Luka Doniq. Walteri, ndryshe nga familja Buss që mbështetej kryesisht në vlerën e klubit, është një miliarder me burime të mëdha financiare. Tifozët e lakersave tashmë presin me padurim ta shohin ndikimin e një pronari të ri e agresiv në prag të NBA Draftit më 25-26 qershor dhe hapjes së merkatos më 6 korrik.

SHKURT
Rrudhani rikthehet te Young Boys

Përfaqësuesi i Kosovës, Donat Rrudhani, pas një sezoni të suksesshëm me Luzernin, do të rikthehet te klubi i tij, Young Boys. Drejtori sportiv i Luzernit, Remo Meyer, ka konfirmuar se skuadra zvicerane nuk do ta aktivizojë opsionin e blerjes së kartonit të lojtarit. “Për shkak të diskutimeve të ndryshme dhe kryesisht për arsye financiare, vendimi u mor kundër aktivizimit të opsionit të blerjes”, ka deklaruar Meyeri. Gjatë periudhës së tij në Luzern ai ka qenë një nga pikat më të forta të skuadrës, duke kontribuar me 9 gola dhe 6 asistime në 31 paraqitje në Superligën e Zvicrës.

Broja, afër transferimit tek Ajaxi

Armando Broja, sipas të gjitha gjasave, do t’i bashkohet skuadrës së madhe nga Holanda, Ajax, kanë raportuar mediet britanike të enjten. Bëhet me dije se Chelsea ka arritur marrëveshja në parim me Ajaxin për ta përfshirë Brojën në ofertën për mbrojtësin e ri, Jorrel Hato. Chelsea po insiston në transferimin e 19-vjeçarit, për të cilin Ajaxi po kërkon të paktën 50 milionë euro, por me përfshirjen e Brojës gjërat kanë ndryshuar pasi ekipi holandez është i interesuar për sulmuesin shqiptar. Kartoni i Brojës plus 30 milionë euro do të mjaftojnë që Chelsea ta realizojë transferimin e holandezit Hato që është ndër më të kërkuarit në Evropë. Në anën tjetër, Broja nuk bën pjesë në planet e Chelseat edhe pse ka kontratë deri në verën e vitit 2028. Sezonin e fundit ai ishte i huazuar tek Evertoni, kurse më herët ka luajtur edhe për Fulhamin, Southamptonin e Vitessen.

Al Hilali synon transferimin e Osimhenit dhe Hernandezit

Al Hilali nuk ka ndër mend të ndalet vetëm me blerjen e Simone Inzaghit. Klubi saudit pritet të nisë një tjetër ofensivë, këtë herë për t’i dhuruar teknikut italian disa lojtarë klasë. Sipas “Sky Sport”, Al Hilali është i fiksuar pas idesë për ta transferuar në Arabinë Saudite sulmuesin e Napolit, Victor Osimhen. Nigeriani do të rikthehet në Napoli pas huazimit te Galatasary, në pritje për të kuptuar se cili është plani i trajnerit Conte apo i presidentit De Laurentiis. Jo vetëm Osimhen, Al Hilali është vënë në ndjekje edhe të Theo Hernandezit, i gatshëm të plotësojë çdo kërkesë ekonomike të Milanit, por dhe të lojtarit, pasi pjesa më e vështirë është për ta bindur anësin francez që të largohet nga Evropa.

PSG-ja ‘kërcënon’ Donnarumman me largim

Paris Saint-Germaini thuhet se i ka lëshuar një ultimatum të ashpër portierit Gianluigi Donnarumma, duke i thënë të pranojë një kontratë të re ose do të shitet këtë verë. Kontrata e 26-vjeçarit italian është e vlefshme deri në vitin

2026, por bisedimet për zgjatjen e saj kanë ngecur për shkak të mosmarrëveshjeve mbi pagën. Klubi, i cili së fundmi fitoi Ligën e Kampionëve, është i etur të mbajë njërin nga lojtarët kyç, por nuk është i gatshëm t’i përmbushë të

gjitha kërkesat e tij financiare. Ndërkohë, Manchester Unitedi po tregon interesim të fortë për Donnarumman. Raportet thonë se portieri tashmë ka diskutuar një transferim të mundshëm në Ligën Premiere me shokët e tij të ekipit.

Megjithatë, Donnarumma ka deklaruar publikisht se PSG mbetet përparësia e tij, megjithëse ai po i mban të gjitha opsionet hapur në rast se negociatat dështojnë. Manchester City, Interi dhe Napoli thuhet se janë të

interesuar për portierin italian. Për çdo rast, PSG tashmë po shqyrton një zëvendësim, duke etiketuar Lucas Chevalierin të Lille, i cili është bërë portieri i dytë i zgjedhur për ekipin kombëtar francez.



Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjobiznesi.com,
Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878 info@kolegjobiznesi.com

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë dhe Dega në Prizren:

Kolegji Biznesi shpall konkursin publik të rregullt për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2025/2026, në të gjitha programet e studimit të akredituara nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës dhe të licencuara nga MASHT.

Të drejtë aplikimi dhe regjistrimi në studimet themelore (Bachelor) e kanë të gjithë kandidatët që e kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë dhe që e kanë përfunduar me sukses testin kombëtar të maturës. Kurse ne studimet Master kanë të drejtë aplikimi dhe regjistrimi të gjithë kandidatët që i kanë përfunduar Studimet Bachelor.

Studime Bachelor	Studime Master
1.Banka dhe Financa në Biznes (Ba) - (3 Vjeçar)	1.Menaxhment dhe Financa – MA-(2 Vjeçar)
2.Menaxhment dhe Ekonomiks (Ba) - (3 Vjeçar)	2.Menaxhimi i Emergjencave – MA-(2 Vjeçar)
3.Menaxhimi i Emergjencave (Ba) - (3 Vjeçar)	
4.Juridik / LLB - (4 Vjeçar)	
5. Shkenca Kompjuterike Bsc - (3 Vjeçar)	

- Studentët të cilët aplikojnë në studimet Bachelor, i bashkëngjisin aplikacionit:
- Certifikata e maturës shtetërore – origjinale ose kopje e noterizuar;
 - Diploma e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
 - Dëftesat e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
 - Ekstrakti i lindjes;
 - Kopje e letërnjoftimit;
 - 2 fotografi (formati pasaportë)

- Studentët të cilët aplikojnë në studimet Master, i bashkëngjisin aplikacionit:
- Diplomën ose certifikatën e fakultetit (të noterizuar)
 - CV
 - Certifikatën e lindjes
 - Kopjen e letërnjoftimit
 - Dy foto

038/045- 500 878 : 029-230-555
044/ 049/ 048- 500 – 878



Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjobiznesi.com, info@kolegjobiznesi.com
Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë:

SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK

I. PROFESORA

1. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Ekonomik**,
2. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Juridik**,
3. **Dy (2)** mësimdhënës në programin - **Menaxhimi i Emergjencave**,
4. **Një (1)** mësimdhënës në programin – **Shkenca Kompjuterike**,

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Kolegjit Biznesi.

Për vendin e punës mësimdhënës, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatëse dhe punime në revistat si SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE.

Njohja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar (vërtetuar), Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.

Kandidatët që kanë doktoruar jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Konkursi mbetet i hapur nga **18.06.2025 deri më 30.06.2025**.

Paraqitja e dokumenteve: Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, 10000 Prishtinë, Kosovë ose përmes e-mail: info@kolegjobiznesi.com

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: www.kolegjobiznesi.com

Aplikacionin mund ta shkarkoni në ueb faqen: www.kolegjobiznesi.com ose mund ta merrni në zyrat e Kolegjit Biznesi.

NJOFTIM MBI ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË " CC Apartments" L.L.C.

Në përputhje me kërkesat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në Kosovë dhe të Marreveshjes dhe Statutit se Shoqërisë, të plotësuara dhe ndryshuara, Kuvendi i Aksionareve të shoqërisë " CC Apartments" L.L.C., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër unik identifikues 810168395 (“Shoqëria”) ka nxjerr:

VENDIM PËR ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË me datë 02.06.2025

Kapitali i shoqërisë zvogëlohet nga nga vlera e regjistruar **6,891,246.15 Euro në 162,102.00 Euro**

Të gjithë Kreditorët e Shoqërisë kanë të drejtën që në afatin 21 ditor nga dita e publikimit të këtij njoftimi në shtypin ditor ti drejtohen Shoqërisë me kërkesë për siguri shtesë ose kërkesë për mos-zvogëlim të kapitalit. Kërkesat i drejtohen Shoqërisë përmes postës së rregullt në adresën:

"CC Apartments" L.L.C , Zona Industriale Prishtinë-Fushë Kosovë., Fushë Kosove.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ensar Gafuri shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Ruzhdi Berisha” Dragash.

- Jeton Xhafiqi shpall të pavlefshme patentë shoferin (lejen e kerrit) Piranë Prizren.

- Aleksandar Mihajlovic shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 81070307.

- Kujtim Zeneli shpall te pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme të gjimnazit “Frang Bardhi”.

- Lule Osmani shpall të pavlefshme diplomën e sh,m, të Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Liberta Spahija shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

